



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: 7.3.2023, me fillim në orën 10.00. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, z. Bajram Morina.

**Kryesuesi:** Fillimisht përshëndetje për të gjithë, faleminderit për praninë tuaj! Përshëndetje për shefin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim zt. Lendrit Qeli, përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, zëvendëskryesuesin, përshëndetje për anëtarët dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i dytë për vitin 2023, për takimin e sotëm, i kemi këto pika të rendit të ditës:

### REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit të punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim për vitin 2022;
3. Të ndryshme;

#### 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim rrëth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime, procesverbalit kalon.

#### 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim për vitin 2022;

**Lendrit Qeli:** Faleminderit kryesues, të nderuar të pranishëm! Raporti është i publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në pika të shkurtra do të mundohem t'i trajtoj çështjet. Në kuadër të fushës së arsimit, në vitin 2022 si zyre kemi punuar me të gjithë akterët për forcimin e pozitës së komuniteteve joshumicë në fushën e shkollimit. Sa i përket numrit të nxënësve që vijojnë, i kam rezervat e mia, në fund të vitit fillon procesi i regjistrimit civil dhe me informata do të jemi më mirë dhe më saktë. Numri i atyre që kanë aplikuar për bursa, këtë vit është pak më i madh se në vitin e kaluar, rrëth 7 nxënës të shollave të mesme. Kemi hapur qendrën arsimore për komunitete në shkollën “Gëzim Hamza, piktori” dhe presim që shumë shpejtë njëra prej OJQ-ve vendore ta fillojë punën atje. Udhëzimi administrativ parashev që pas një periudhe të punës së kësaj qendre, duhet të transferohet në kompetenca të nivelit lokal, që në këtë rast i bie në Drejtorinë e Arsimit. Te Shëndetësia dhe Mirëgenia Sociale, konsideroj që edhe këtu kemi pasur projekte të rëndësishme, që për herë të parë janë realizuar në komunën tonë. Kemi ngritur vetëdijken me fushata të ndryshme sensibilizuese për vaksinimin e rregullt të fëmijëve, prej moshës 0-10 vjeç. Për këtë gjë, organizata “Balkan Sunflowers”, në bashkëpunim me zyrën tonë, ka arritur që ta punësojë një facilitator, ku për çdo ditë shkon dhe i viziton familjet dhe njëkohësisht e bën ndërmjetësimin QKMF - Komunitet për vaksinim. Te mirëgenia sociale, kemi gjetur forma të mbështetjes në raste të ndryshme, mbështetje me qira dhe ndërtim të shtëpive, kjo formë e mbështetjes do të vazhdojë duke u rritur vazhdëmisht. Në këtë fushë, ZKKK-ja ka qenë e angazhuar kryekëput si bartëse e programit për banim social 2022-2025, që i falënderojmë asambleistët që plani ka kaluar tutje për finalizim. Te barazia gjinore, në çfarëdo formati, barazia gjinore duhet të jetë e njëjtë dhe nuk do të duhet ndarë për nga përkatësia etnike. Projekti ka paraparë fushata sensibilizuese mbi parandalimin e dhunës në familje për shkak të gjendjes sociale, problemeve në arsim etj... kemi vazhduar me fushata të tjera për ngritjen e vetëdijes te trashëgimia. Te “start-up bizneset” në bashkëpunim me organizatën IOM, jemi munduar t'i mbështesim gratë se si të startojnë me një biznes. Janë mbështetur disa pjestarë të komuniteteve joshumicë, një grua në Xerxë, njëra prej përfituesve që ka filluar me biznesin e saj, që ka të bëjë kryesisht me agro-biznes (bletari). Një familje tjetër në Çifllak është

mbështetur në bashkëpunim me organizatën "Help". Te riatdhesimi dhe kthimi i qëndrueshëm: Te pjesa e riatdhesimit siç jeni në dijeni, ZKKK-ja e bën punën administrative, e paraqet në komision dhe komisioni më tutje, në bazë të rregullores, inicion procedurat. Te infrastruktura, keni mundur ta shihni që është finalizuar kanalizimi dhe kubëzimi i rrugës në lagjen e epërme (lagje me banim multiitetnik) me mbështjetje nga MAPL dhe bashkëfinancim i Komunës së Rahovecit. Gjithashtu është intervenuar edhe në një park të vogël, në ndriçim poashtu, në po të njëjtën lagje. Te çështja e sigurisë, kam proceduar gjëra në KKSBB dhe kemi një situatë të qetë dhe stabile. Në fund, kam paraqitur edhe disa konkluzione, fillimi që Zyrës për Komunitete duhet t'i rritet buxheti dhe në të njëjtën kohë t'i ndërrrohet destinacioni. Kemi kërkuar që të kemi edhe subvencione, sepse shumica e zyreve në regjione të ndryshme e kanë këtë kod dhe e kanë më të lehtë të intervenojnë në çështje të ndryshme që vijnë si kërkesa të pjesëtarëve të komuniteteve. Për momentin, është e pamundur të intarevojnë në këto fusha, sepse fondin e kemi vetëm për investime kapitale. Kemi kërkuar një veturë për dalje më të shpeshtë në terren dhe aktivitete të shtuara, sepse të gjitha aktivitetet i organizojmë me vetura private.

### 3. Të ndryshme:

**Ramë Berisha:** Përshtendje për të gjithë! Raporti i Zyrës rreth vaksinimit është një punë mjaft e mirë, sepse duhet përkushtuar në shëndet. Sfera e edukimit është po ashtu bazë e jetës dhe forcë e së ardhmes së një shteti pa marrë parasysh fenë, gjininë, etninë. Punëtorët e arsimt duhet t'i bindin fëmijët për disiplinë me shembuj të mirë frytdhënës.

**Edonë Kryeziu:** Përshtendje për të gjithë! Kam një pyetje për ty kryesues. Kur do t'i ftosh drejtorët e drejtoreve të na tregojnë specifikisht se çka kanë bërë për komunitete, jo që Lendriti nuk po na raporton, por besoj që barrën e përgjegjësisë e kanë edhe ata. Duke qenë pjesëmarrëse e rregullt e këtij komiteti, e mbaj në mend që vetëm një herë prezent ka qenë drejtori i arsimt, Avni Morina.

**Kryesuesi:** Faleminderit për pyetjen Edonë! Vitin e kaluar nga Drejtoria për Shëndetësi, zonja Shemsie Deliu, ka qenë prezente për raportim, drejtori i arsimt, z. Avni Morina, gjithashtu, ka raportuar. Drejtorin e Shërbimeve Publike, z. Përparrim Krasniqi, e kemi fjuar, por për shkak të agjendës së ngjeshur nuk ka ardhur. Gjithashtu, këtë vit do të vazhdojmë me ftesa për drejtoritë përkatëse.


**Dusan Stojanovic:** Një pyetje për z. Lendrit Qeli, sa i përket vendosjes së pengesave. Më herët na është thënë që ZKKK-së t'i drejtuhemi me kërkësë, në ndërkohë na është thënë që të njëjtën kërkësë ta drejtojmë në Drejtorinë e Financave. Për arsyë të ngasjes së shpejtë të veturave, na duhen sa më shpejt pengesat në atë lagje, sepse siguria e fëmijëve sado pak është në rrezik.

**Lendrit Qeli:** Sa i përket kërkësës, ZKKK-ja nuk ka pranuar zyrtarisht asnjë kërkësë me shkrim, nuk mund të veprojmë në diçka pa e pasur kërkësen. Sa i përket Drejtorisë së Financave, një kërkësë e tillë nuk dorëzohet atje, sepse Drejtoria e Financave nuk zbaton kërkesa të tillë, por ajo e Shërbimeve Publike. E rëndësishme është që e kemi një kompani të kontraktuar për pengesa të tillë në rrugë.

**Kryesuesi:** Ju faleminderit! Me urimin e festës së mësuesit, po e përmbyllim takimin e sotëm.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Procesmbajtësi:



Albion Krasniqi



Kryesuesi i mbledhjes:

Bajram Morina